



01 Nr. 643/24 Dt. 17.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja b dhe g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 12 të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet e Organizatave Jo Qeveritare (OJQ), në fushën e kulturës në Komunën e Prizrenit

1

1.1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

1.2. Mbështetja financiare publike për projektet e OJQ-ve do të ofrohen nga Buxheti i Komunës së Prizrenit, kodi ekonomik subvencione në shumën prej 20.000.00 € (njëzetmijë euro).

2

Mjetet e përmendura në nenin 1.2. të këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe dispozitave të Rregullores MF –Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

3

Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Arkivës së Kryetarit.

